



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 5706/1 Prot.

Roskovec, më 10, 10 2023

VENDIM

Nr. 2, Datë 10, 10 2023

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONSULTIMIT PUBLIK PËR PBA 2024-
2026, BUXHETIT DHE PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2024.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 18 dhe 54, ligjit 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak për Konsultimet Publike, Kryesia e Këshillit,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurës për realizimin e konsultimit publik të projektaktit të buxhetit afatmesëm (PBA) 2024-2026, Buxhetit dhe Paketës Fiskale për vitin 2024.
2. Ngarkohet Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit të Këshillit Bashkiak, për planifikimin dhe realizimin e konsultimit publik duke përcaktuar afatet përkatëse të realizimit të procesit.
3. Sekretariati i Këshillit Bashkiak asiston komisionin në procesin e planifikimit dhe realizimit të konsultimit publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

Afrim Plaka

Ermira Buzi

Sara Bibo

